



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova - Ministry of Internal Affairs

Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police



PLANI ZHVILLIMOR STRATEGJIK STRATEŠKI RAZVOJNI PLAN STRATEGIC DEVELOPMENT PLAN

2016 - 2020

“KRENAR PËR SHËRBIMIN”

PËRMBAJTJA

I.	FJALA HYRËSE E MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDSHME.....	4
II.	FJALA HYRËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË KOSOVËS.....	5
III.	METODOLOGJIA.....	7
IV.	MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT E POLICISË SË KOSOVËS.....	7
	1. MISIONI.....	7
	2. VIZIONI.....	7
	3. VLERAT.....	7
V.	PARIMET E PËRGJITHSHME.....	8
	1. PARIMI I PROFESIONALIZMIT.....	8
	2. PARIMI I BESUESHMËRISË.....	8
	3. PARIMI I LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT.....	8
	4. PARIMI I PROPORCIONALITETIT.....	8
	5. PARIMI I TRANSPARENCËS.....	8
VI.	KORNIZA LIGJORE.....	9
VII.	MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE.....	10
VIII.	DOKUMENTET STRATEGJIKE.....	10
IX.	OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE SPECIFIKE.....	11
	1. OFRIMI I SIGURISË PUBLIKE DHE FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME QYTETARË.....	11
	2. PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE KORRUPSIONIT, KRIMEVE TË RËNDA SI DHE TERRORIZMIT.....	11
	3. KONTROLLI DHE MBIKËQYRJA E KUFIRIT SHTETËROR.....	12
	4. AVANCIMI I MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE.....	13
	5. STANDARDIZIMI I INFRASTRUKTURËS FIZIKE, TEKNIKE DHE I TEKNOLOGJISË INFORMATIVE.....	13
X.	MONITORIMI, ZBATIMI DHE VLERËSIMI.....	14
	1. MONITORIMI.....	14
	2. PROCESI I ZBATIMIT TË STRATEGJISË.....	14
	3. SISTEMI I VLERËSIMIT DHE RISHIKIMIT.....	14



z. Skender Hyseni

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME


FJALA HYRËSE E MINISTRIT TË PUNËVE TË BRENDSHME

Siguria e qytetarëve dhe garantimi i mbrojtjes së të drejtave të tyre është misioni kryesor institucional i Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kjo bëhet përmes parandalimit dhe veprimtarisë në një sërë fushash, duke përfshirë luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit, sigurimin e transportit, luftën kundër trafikut të drogës dhe sigurimin e eventeve të ndryshme shoqërore dhe sportive.

Gjithashtu, misioni ynë është të përmirësojë cilësinë e shërbimit për qytetarët dhe të ofrojmë kushte maksimale për mbrojtje të dinjitetit dhe të drejtat themelore të çdo individ.

Identifikimi i nevojave në çdo fushë, përcaktimi i objektivave dhe përdorimi i mjeteve optimale për arritjen e rezultateve efektive, janë parakushtet më të mira për sukses. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi, Policia e Kosovës duke pasur në fokus reformimin e vazhdueshëm të saj, ka përgatitur planin zhvillimor strategjik 2016-2020, që me siguri do të ndikojë në performancën e saj, me qëllim të ofrimit të shërbimit të një cilësie më të lartë ndaj qytetarëve të vendit. Plani

i tanishëm zhvillimor na tregon qartë edhe dobësitë në kuadër të sistemit dhe çfarë hapa konkretë duhet të bëhen për të evituar këto mangësi. Gjithashtu janë evidentuar edhe pesë objektivat të cilat synohen të arrihen. Këto objektiva përfshijnë: ofrimi i sigurisë publike dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarë, parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve të rënda si dhe terrorizmit, kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit shtetëror, avancimi i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe standardizimi i infrastrukturës fizike, teknike dhe i teknologjisë informative. Ndryshimi dhe reformat marrin kohë dhe evoluojnë krahas nevojave e shoqërisë, prandaj ky plan zhvillimor është një hap në një proces të vazhdueshëm drejt ndjekjes së përsosmërisë. Zbatimi i këtij plani, jemi të bindur që do të jetë një nga prioritetet kryesore të menaxhmentit të Policisë së Kosovës, ndërsa presim që shumë shpejt të shihen rezultatet e para, të cilat do të ndikojnë drejtpërdrejt në vetë organizatën, në shoqëri dhe te partnerët tanë, duke krijuar një klimë ku do të sundojë ligji dhe ku të gjitha segmentet e shoqërisë do të funksionojnë sipas standardeve më të larta demokratike.



Z. Shpend MAXHUNI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I POLICISË
SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

FJALA HYRËSE E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË POLICISË SË KOSOVËS

Duke qenë të vetëdijshëm se siguria e përgjithshme është ndër shtyllat kryesore të realizimit të jetës normale në shoqëri, Policia e Kosovës është në zhvillimin dhe rritjen e saj, si në aspektin teknik edhe në atë profesional. Misioni ynë është i qartë dhe ne jemi të përkushtuar drejt arritjes së kryerjes së detyrave, gjithmonë në bashkëpunim dhe bashkëveprim me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare si dhe me komunitetin, duke vepruar si një organizëm i shëndoshë dhe funksional.

Ne po ndjekim trendët e zhvillimeve të gjithëmbarshme, të cilat ndikojnë në shtimin e përgjegjësiwe policore dhe këtë po e bëjmë duke u profesionalizuar, modernizuar, si dhe duke hartuar plane afatgjata për arritjen e objektivave të vendosura.

Në vazhdimësi të Planit Strategjik 2011-2015, me vetëbesim dhe me një siguri edhe më të madhe do të vazhdojmë punën me Planin e ri Zhvillimor Strategjik 2016-2020, ku synojmë të arrijmë objektivat e qarta të planifikuara. Në këtë plan paraqiten misioni, vizioni, vlerat dhe objektivat në përputhje me qëllimet strategjike të Policisë së Kosovës për pesë vitet e ardhshme.

Në vitet në vijim, në bashkëpunim me institucione tjera, me shoqërinë civile dhe me komunitetin në përgjithësi, duke vepruar në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi dhe me vlerat demokratike, ne do të ofrojmë siguri që çdo qytetar i Republikës së Kosovës të jetojë dhe të veprojë i lirë, i sigurt, pa pasur frikë se dikush mund t'ia cenojë të drejtat e tij të garantuara.

Në aspektin e brendshëm organizativ, në kuadër të këtij plani strategjik, ne synojmë ndërtimin dhe funksionalizimin e të gjithave njësiteve policore, në mënyrë që të jemi të gatshëm profesionalisht të marrim të gjitha përgjegjësitë që bien në fushëveprimin e organizatës sonë.

Në këtë plan parashihet modernizimi i pajisjeve dhe standardizimi i tyre në shërbim të punonjësve tanë, avancimi i kontrollit të mbikëqyrjes së kufirit në funksion të parandalimit dhe luftimit të krimit ndërkufitar, luftimi i krimit të organizuar dhe luftimi i ekstremizmit dhe radikalizmit.

Policia e Kosovës është duke u treguar një partner serioz edhe në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. Nevoja e përditshme e këtij bashkëpunimi me polici të vendeve tjera

PLANI ZHVILLIMOR STRATEGJIK

rajonale dhe ndërkombëtare na shtyn që ne të vendosim objektiv të qartë edhe në planin strategjik, që të anëtarësohemi në të gjitha institucionet ndërkombëtare për zbatimin e ligjit, si: INTERPOL, EUROPOL, SELEC, FRONTEX dhe të tjera.

Brenda këtij plani strategjik kemi përfshirë edhe planin e veprimit i cili është specifik, i matshëm

dhe praktik, duke përfshirë indikatorët e performancës, të cilët do t'i monitorojmë dhe do t'i matim.

Prandaj, besojmë shumë në angazhimin dhe përkushtimin maksimal të të gjithë personelit policor dhe në veçanti menaxhmentit të lartë për realizimin e këtij plani zhvillimor, në tërësinë e tij.

III. METODOLOGJIA

Plani zhvillimor strategjik i Policisë së Kosovës është bazuar në parimet themelore që rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ligjet dhe strategjitë e ndryshme të Qeverisë dhe i cili është hartuar pas kryerjes së një sërë studimesh dhe analizash të punës së Policisë së Kosovës, vlerësimet e jashtme nga raportet e DASH-it, raportet e progresit të BE-së, udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave, si dhe në bashkëpunim me partnerët e brendshëm dhe të jashtëm dhe si më e rëndësishmja, në nevojat e komunitetit.

Gjatë hartimit të këtij plani, janë marrë në konsideratë edhe praktikatat më të mira të policive të vendeve të zhvilluara. Po ashtu, procesi i hartimit të planit zhvillimor strategjik ka përfshirë konsultimin dhe bashkëpunimin e gjerë me grupe të jashtme të interesit, si: agjencitë e zbatimit të ligjit, partnerët ndërkombëtarë dhe grupe tjera të interesit nga shoqëria civile, po ashtu fokus i është kushtuar edhe analizës dhe vlerësimit të brendshëm.

Në bazë të paraqitjes së analizës dhe procesit të konsultimit janë përcaktuar misioni, vizioni, parimet dhe vlerat, në linjë me objektivat specifike dhe aktivitetet në përmbushjen e këtij plani.

IV. MISIONI, VIZIONI DHE VLERAT E POLICISË SË KOSOVËS

Misioni

Të ofrojë siguri dhe shërbime për të gjithë personat në Kosovë bazuar në ligj, praktikatat më të mira dhe standardet e policimit demokratik.

Policia e Kosovës do të përmbushë misionin duke:

- Ofruar siguri publike (sigurinë e jetës dhe pronës);
- Mbrojtur të drejtat dhe liritë e njeriut;
- Bashkëpunuar me komunitetin dhe institucionet;
- Kontrolluar dhe mbikëqyrur kufirin;
- Përmirësuar performancën e organizatës;
- Parandaluar dhe luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe format tjera të aktiviteteve kriminale.

Vizioni

“Policia profesionale, e trajnuar, e pajisur mirë, efikase në ofrim të sigurisë, në zbatim të ligjit, parandalimit dhe luftimit të krimit, duke qenë shembull në rajon, gjithnjë në mbështetje dhe besnike ndaj komunitetit”.

Vlerat

Lidershipi: çdo zyrtar është përgjegjës për t’u dëshmuar si shembull dhe me dedikim personal pavarësisht ku punon.

PLANI ZHVILLIMOR STRATEGJIK

- **Orientimi ndaj shërbimit:** secili zyrtar kontribuon në kualitetin e jetës ndaj komunitetit që i shërben.
- **Integriteti:** ne do të punojmë me drejtësi, ndershmëri dhe sinqeritet, gjithnjë bazuar në standardet më të larta etike dhe morale.
- **Dedikimi:** vigjilent dhe pro-aktiv në organizatë dhe komunitet, i vetëmotivuar dhe kreativ.
- **Puna ekipore:** puna ekipore është esenciale për arritjen e suksesit. Në ekip duhet të kyçen edhe zyrtarët nga brenda po ashtu edhe komuniteti për arritjen dhe përmbushjen e objektivave strategjike.

V. PARIMET E PËRGJITHSHME

- 1. Parimi i profesionalizmit** - Parandalimi dhe luftimi i krimit kërkon ekspertë të mirë, shkëmbim të përvojave, mjete të përshtatshme/praktikat më të mira dhe profesionalistë efikas. Kjo nënkupton kombinimin e trajnimit, edukimit dhe zhvillimit profesional për Policinë e Kosovës si dhe përkujdesjen për të rekrutuar kandidatë cilësorë;
- 2. Parimi i besueshmërisë** - Institucionet përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e krimit duhet të kujdesen për ndërtimin e besimit në ruajtjen e të dhënave dhe informacioneve të ardhura nga qytetarët nga keqpërdorimi nga ata që kanë qasje në to;
- 3. Parimi i lirive dhe të drejtave të njeriut** - Nënkupton respektimin dhe garantimin e lirive dhe të drejtave të të gjithë individëve, pavarësisht përkatësisë etnike, gjinisë, moshës, religjionit, gjatë të gjitha fazave të angazhimit të institucioneve në parandalimin dhe luftimin e krimit;
- 4. Parimi i proporcionalitetit** - Nënkupton ushtrimin e autoritetit policor në parandalimin dhe luftimin e krimit, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në nivelin që nevojitet për të arritur objektivat legjitime, me mjete dhe metoda të përshtatshme, kohë sa më të shkurtër të mundshme si dhe pasoja sa më pak të dëmshme;
- 5. Parimi i transparencës** - Ky parim nënkupton një qëndrim pro-aktiv të Policisë së Kosovës, me qëllim të informimit të qytetarëve për punën e saj dhe mirëkuptim për secilin qytetar pa dallim.

VI. KORNIZA LIGJORE

Policia e Kosovës, me qëllim të zbatimit të Planit Zhvillimor Strategjik mbështetet edhe në bazën e gjerë legislative, por nuk kufizohet vetëm në:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Kodi Penal i Kosovës;
- Kodi i Procedurës Penale të Kosovës;
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur;
- Ligji për Policinë;
- Ligji për përgjimin e telekomunikimeve;
- Ligji për Klasifikim të Informatave dhe Verifikimin e Besueshmërisë;
- Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;
- Ligji për Rendin dhe Qetësinë Publike;
- Ligji për Tubimet Publike
- Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor
- Ligji për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit;
- Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës;
- Ligji për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështjet Penale;
- Ligji për Marrëveshjet Ndërkombëtare;
- Ligji për Kontrollin dhe Mbikëqyrjen e Kufirit Shtetëror;
- Ligji për Azil
- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik;
- Ligji për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose të Konfiskuar;

Konventat dhe aktet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës, që ndikojnë në fushën e zbatimit të ligjit:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe protokollet e saj;
- Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

VII. MARRËVESHJET NDËRKOMBËTARE

Për kryerjen e punëve në parandalimin dhe luftimin e krimit, e posaçërisht të krimit të organizuar, përveç akteve ligjore, Policia e Kosovës mbështetet edhe në marrëveshjet bilaterale dhe ndërkombëtare, si dhe dokumenteve tjera në proces të integritimeve evropiane.

VIII. DOKUMENTET STRATEGJIKE

Republika e Kosovës ka hartuar shumë dokumente strategjike për fusha të ndryshme, ku Policia e Kosovës është njëri nga aktet kryesorë në zbatimin e këtyre dokumenteve:

- Strategjia Nacionale dhe Plan i Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2015-2019;
- Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit kundër Krimit të Organizuar 2012-2017;
- Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit kundër Drogave 2012-2017;
- Strategjia Kombëtare dhe Planin e Veprimit kundër Terrorizmit 2012-2017;
- Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2013-2018;
- Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit për Kontrollimin dhe Grumbullimin e Armëve të Vogla dhe të Lehta 2013-2016;
- Strategjia Nacionale dhe Plan i Veprimit për Migrim 2013-2018;
- Strategjia Nacionale kundër Korrupsionit 2013-2017;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin e Krimit 2013-2017;
- Strategjia Kombëtare për ri-integrimin e personave të riatdhesuar në Kosovë 2013-2018;
- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2020;
- Strategjia kundër Falsifikimit dhe Piraterisë 2012-2016;
- Strategjia Nacionale dhe Plan i Veprimit për Siguri në Bashkësi 2011-2016;
- Strategjia për parandalimin dhe eliminimin e punës së fëmijëve në Kosovë 2011-2016;
- Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plan i Veprimit 2015-2018;
- Strategjia për Siguri Kibernetike 2015-2018;
- Strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që shpie në terrorizëm 2015 - 2020;
- Plan Strategjik për mbrojtjen e fëmijëve nga rreziqet në internet 2015-2020;
- Strategjia për asistencë në fushën e sundimit të ligjit 2016-2019.

IX. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE SPECIFIKE

Plani Zhvillimor Strategjik i Policisë së Kosovës mbështetet në këto objektiva strategjike:

- 1. Ofrimi i sigurisë publike dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarë;**
- 2. Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve të rënda si dhe terrorizmit;**
- 3. Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit shtetëror;**
- 4. Avancimi i menaxhimit të burimeve njerëzore;**
- 5. Standardizimi i infrastrukturës fizike, teknike dhe i teknologjisë informative;**

1. Ofrimi i sigurisë publike dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarë

Rendi dhe siguria publike është njëra nga parakushtet për lirinë e lëvizjes, qarkullimin e lirë të njerëzve dhe mallrave si dhe forcimin e bashkëpunimit me qytetarë. Një rëndësi të madhe Policia e Kosovës do t'i kushtojë edhe ngritjes së shkallës së besimit publik në raport me komunitetin, po ashtu theks i veçantë do t'i kushtohet bashkëpunimit me qytetarë në parandalimin/zvogëlimin e akteve kriminale, me qasje pro-aktive të identifikimit, analizimit dhe zgjidhjes së problemit.

Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet edhe ngritjes operacionale sa i përket efektivitetit dhe efikasitetit në funksion të profilizimit të njësive organizative si përgjigje ndaj akteve kriminale drejt zgjidhjes së problemeve dhe adresimin e tyre.

Ofrimi i sigurisë publike dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarë përfshin një sërë objektivash specifike që kanë për qëllim përmbushjen e objektivit strategjik:

- 1.1. Përmirësimi dhe ruajtja e sigurisë publike, parandalimi dhe zvogëlimi i aktiviteteve kriminale;
- 1.2. Ngritja e nivelit të sigurisë në komunikacionin rrugor dhe parandalimi i aksidenteve;
- 1.3. Avancimi i bashkëpunimit dhe vetëdijesimi në partneritet me institucionet dhe komunitetin;
- 1.4. Ngritja e kapaciteteve operacionale dhe profilizimi i njësive.

2. Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve të rënda si dhe terrorizmit

Fenomenet kriminale me kompleksitet shoqëror, siç janë krimi i organizuar, korrupsioni, krimet e rënda dhe terrorizmi, kërkojnë qasje multi-disiplinore për parandalimin, zbulimin dhe kapjen e kryerësve të këtyre veprave penale.

Policia e Kosovës do t'i kushtojë fokus të veçantë fuqizimit të kapaciteteve përmes trajnimit të

zyrtarëve policorë, avancimin e pajisjeve dhe ngritjen e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve vendore të agjencive të zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për shkëmbimin e informatave, bashkimin e lëndëve penale, konfiskimin e aseteve të fituara përmes veprave penale, arrestimin e grupeve kriminale si dhe ofrimin e provave organeve të drejtësisë.

Ndërsa, sa i përket parandalimit dhe zvogëlimit të rrezikut nga radikalizmi i dhunshëm, Policia e Kosovës do t'i kushtojë vëmendje të veçantë vetëdijesimit, identifikimit të hershëm, targetimit dhe trajtimit të personave dhe grupeve kriminale.

Parandalimi dhe luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve të rënda si dhe terrorizmit përfshin një sërë objektivash specifike, si në vijim:

- 2.1. Fuqizimi i kapaciteteve në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve të rënda si dhe terrorizmit;
- 2.2. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar;
- 2.3. Vetëdijesimi i qytetarëve për pasojat e krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve të rënda si dhe terrorizmit;
- 2.4. Identifikimi i hershëm i popullsisë së targetuar për ekstremizëm dhe radikalizëm;
- 2.5. Identifikimi i hershëm i faktorëve që ndikojnë në ekstremizëm dhe radikalizëm;
- 2.6. Rritja e vetëdijes së institucioneve për pasojat e ekstremizmit dhe radikalizmit dhe bashkëpunimi me komunitetin;
- 2.7. Intervenimi me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të rrezikut nga ekstremizmi dhe radikalizmi i dhunshëm.

3. Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit shtetëror

Kontrollimi dhe mbikëqyrja e kufirit shtetëror përbën një angazhim të veçantë në funksion të parandalimit dhe luftimit të krimit ndërkufitar, ngritjes së nivelit të sigurisë në kufi, si dhe krijimin e kushteve për lëvizjen e lirë të njerëzve dhe qarkullimin e mallrave.

Po ashtu, një rëndësi të veçantë do t'i kushtohet edhe pjesëmarrjes në harmonizimin e legjislacionit me direktivat e BE-së në kuadër të proceseve integruese. Policia e Kosovës do t'i kushtojë rëndësi edhe krijimit të mekanizmave për bashkëpunim policor ndërkufitar përmes zbatimit të marrëveshjeve dhe protokolleve bilaterale.

Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit shtetëror do të përfshijë një sërë objektivash specifike që kanë për qëllim përmbushjen e objektivit strategjik, si në vijim:

- 3.1. Avancimi i aktiviteteve në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit;
- 3.2. Zbatimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit në përputhje me standardet e Schengenit;
- 3.3. Krijimi i kushteve për qarkullim të lirë të njerëzve dhe mallrave në kufi;
- 3.4. Kontrolli dhe mbikëqyrja e qarkullimit dhe qëndrimit të të huajve, me qëllim të parandalimit të migrimit të parregullt;
- 3.5. Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore të Policisë Kufitare.

4. Avancimi i menaxhimit të burimeve njerëzore

Policia e Kosovës do t'i kushtojë rëndësi të madhe ngritjes dhe avancimit të performancës, duke aplikuar standarde më të mira për personelin policor përmes aplikimit të sistemit të menaxhimit të personelit, trajnimeve në vazhdimësi dhe kujdesit ndaj shëndetit.

Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet edhe ngritjes së cilësisë së planprogrameve të trajnimeve, duke filluar nga trajnimet themelore deri tek ato të specializuara, në funksion të plotësimit të nevojave të të gjithë të punësuarve.

Policia e Kosovës do të vazhdojë të përkujdeset edhe për shkëmbimin e përvojave me institucionet e zbatimi të ligjit me shtetet e ndryshme përmes pjesëmarrjeve në konferenca, seminare, vizita studimore dhe trajnime në fusha të ndryshme.

Avancimi i menaxhimit të burimeve njerëzore do të përfshijë një sërë objektivash specifike, që kanë për qëllim përmbushjen e objektivit strategjik, si në vijim:

- 4.1. Zhvillimi i karrierës së punonjësve të Policisë së Kosovës në përputhje me performancën në punë;
- 4.2. Avancimi i sistemit të menaxhimit të personelit në Policinë e Kosovës;
- 4.3. Kujdesi shëndetësor për të gjithë të punësuarit përmes përkujdesjes shëndetësore efikase, brenda burimeve të disponueshme;
- 4.4. Ngritja e cilësisë së programeve trajnuese.

5. Standardizimi i infrastrukturës fizike, teknike dhe i teknologjisë informative

Policia e Kosovës përmes hartimeve të projekteve për standardizimin e infrastrukturës fizike dhe tekniko-teknologjike do të ngritë dhe fuqizojë performancën dhe profesionalizimin e punës së saj dhe njëkohësisht do ta ngritë edhe besueshmërinë dhe perceptimin e qytetarëve që Policia e Kosovës është duke rrugëtuar në hap me policitë e shteteve demokratike.

Rëndësi të madhe do t'i kushtohet ngritjes së nivelit të sigurisë kibernetike përmes aplikimit të teknologjisë së avancuar dhe ngritjes profesionale të zyrtarëve, në mënyrë që të parandalojë format e kërcënimeve dhe keqpërdorimeve.

Standardizimi i infrastrukturës fizike, teknike dhe i teknologjisë informative do të përfshijë një sërë objektivash specifike që kanë për qëllim përmbushjen e objektivit strategjik, si në vijim:

- 5.1. Përmirësimi dhe avancimi i kushteve të infrastrukturës dhe standardizimi i objekteve policore;
- 5.2. Rregullimi i statusit pronësor të objekteve policore;
- 5.3. Zgjerimi dhe avancimi i sistemeve informative të Policisë së Kosovës;
- 5.4. Ngritja e nivelit të sigurisë kibernetike;
- 5.5. Instalimi i sistemit digjital të monitorimit të sigurisë së kamerave CCTV dhe ANPR;
- 5.6. Avancimi i sistemit të komunikimit të PK-së;

X. MONITORIMI, ZBATIMI DHE VLERËSIMI

1. Monitorimi do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e planit zhvillimor strategjik, për të matur në proces shkallën e realizimit të objektivave të saj, për të vlerësuar nevojën dhe për të përcaktuar drejtimit e organizatës, respektivisht departamenteve, veçanërisht lidhur me aktivitetet. Monitorimi i Planit Zhvillimor Strategjik do të ngritë efikasitetin dhe efektivitetin e tij dhe njëkohësisht ngritjen e performancës së personelit policor në organizatën policore.

2. Procesi i zbatimit të strategjisë, do të jetë një proces i realizimit të objektivave strategjike, objektivave specifike si dhe aktiviteve. Plan i veprimit ka paraparë aktivitete konkrete dhe të matshme që do të zbatohen për periudhën pesë (5) vjeçare respektivisht, nga viti 2016-2020. Zbatimin e Planit Zhvillimor Strategjik do ta bëjë secila njësi, respektivisht departament, sipas aktiviteve të parapara me këtë plan përmes raporteve periodike.

3. Sistemi i vlerësimit dhe rishikimit

Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore do ta bëjë vlerësimin e realizimit të aktiviteve të parapara në Planin e Veprimit së paku dy (2) herë në vit ndërsa rishikimi një (1) herë në vit. Vlerësimi bëhet përmes raporteve të pranura nga departamentet/njësitë organizative që sipas planit kanë përgjegjësi për përmbushjen e aktiviteve.

LISTA E SHKURTESAVE

AAPSK	Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar
AKSP	Akademia Kosovare për Siguri Publike
AKK	Agjencia Kundër Korrupsionit
ANPR	Lexues Automatik i Targave të Automjeteve
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
BE	Bashkimi Evropian
CCTV	Sistemi i Kamerave Vëzhguese
CERT	Ekipi Reagues Emergjent Kompjuterik
CSIRT	Ekipi Reagues për Incidente të Sigurisë Kompjuterike
DASH	Departamenti Amerikan i Shtetit
DBNj	Departamenti i Burimeve Njerëzore
DPSÇL	Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore
DO	Departamenti për Operacione
DK	Departamenti i Kufirit
DH	Departamenti i Hetimeve
DShM	Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse
EVSB	Ekipet Vepruese për Siguri në Bashkësi
EXBS	Programi për Sigurinë e Kufijve dhe Kontrollit të Eksportit
ICITAP	Programi Ndërkombëtar i Ndihmës për Trajnim të Hetimeve Penale
ILECU	Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Fushën e Zbatimit të Ligjit
IOM	Organizata Ndërkombëtare për Migracion
IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
KK	Kuvendet Komunale
KLSP	Komitetet Lokale për Siguri Publike
KKSB	Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi
KFOR	Misioni ushtarak i NATO-s në Kosovë
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MF	Ministria e Financave
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MI	Ministria e Infrastrukturës
MIE	Ministria për Integrime Evropiane
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSh	Ministria e Shëndetësisë
PSO	Procedura Standarde e Operimit
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
OJQ	Organizatë Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
UNHCR	Komisariati i Lartë për Refugjatë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
ZIMP	Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun

PLANI I VEPRIMIT 2016-2020

Objektivi strategjik	Objektivi specifik	Aktiviteti	Departamenti / Drejtoria përgjegjëse	Institucioni/ Departamenti / Drejtoria mbështetëse	Afati kohor	Kosto financiare	Parametri matës
1. Ofrimi i sigurisë publike dhe forcimi i bashkëpunimit me qytetarët	1.1. Përmirësimi i dhe ruajtja e sigurisë publike, parandalimi dhe zvogëlimi i aktiviteteve kriminale	1.1.1. Zvogëlimi i rasteve kriminale dhe rritja e zbulueshmërisë.	DO, DH, DK	DBNj, DShM, prokuroritë dhe gjykatat	Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar	Numri i rasteve
		1.1.2. Ujla e kohës së reagimit policor.	DO, DK	DBNj, DShM	Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar	Koha e reagimit
		1.1.3. Ngrija e bashkëpunimit me qytetarët për çështjet e sigurisë.	DO, DH, DK, ZIMP	DShM, forumet e sigurisë, shoqëria civile, mediat	Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar / donacion	- Numri i takimeve - Numri i projekteve
		1.1.4. Marrja e përgjegjësisë së sigurisë së Manastirit të Deçanit dhe përmirësimi i kushteve të punës për sigurinë e objekteve tjera të trashëgimisë kulturore dhe fetare.	DO, DShM	MKRS, KK, DH, DBNj, bashkësitë fetare dhe partnerët ndërkombëtarë	Në vazhdimësi	Grant qeveritar 63.000 euro	- Përgjegjësia e marrë - Kushtet e përmirësuar
	1.2. Ngrija e nivelit të sigurisë komunikacionin rrugor dhe parandalimi i aksidenteve.	1.2.1. Avancimi i punës në partneritet me komunitetin dhe institucionet.	DO, ZIMP	Institucionet partnere, DShM, forumet e sigurisë, shoqëria civile, mediat	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Raportet e publikuara (sondazhet, hulumtimet, vlerësimet)
		1.2.2. Furnizimi dhe modernizimi i pajisjeve për	DO, DShM	Ministria e Infrastrukturës, Kuvendet	2018	4.250.000 euro/donacion	- Numri i pajisjeve të furnizuara

1.3. Avancimi i bashkëpunimit dhe vetëdijesimi në partneritet me institucionet dhe komunitetin.	rregullim, kontrollim, identifikim dhe dëshim në komunikacion rrugor (pajisjet digjitale statike, mobile dhe nga ajri).		Komunale			- Numri i pajisjeve funksionalizuar
	1.2.3 Organizimi i fushatave për edukim dhe ngritjen e vetëdijesimit në komunikacionin rrugor.	DO, ZIMP	Institucionet partnere, forumet e sigurisë, shoqëria civile, mediat	Në vazhdimësi	Donacion	Numri i fushatave të realizuara
	1.3.1. Organizimi dhe pjesëmarrja në takime, debate dhe ligjërata.	DO, DH, DK	DShM, institucionet partnere, forumet e sigurisë, shoqëria civile, mediat	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i takimeve, debateve dhe ligjëratave
	1.3.2. Nxjerrja dhe implementimi i projekteve vetëdijesuese.	DO, DH, DK	DShM, Institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare, forumet e sigurisë, shoqëria civile, mediat	Në vazhdimësi	Donacion	Numri i projekteve
	1.3.3. Përfshirja e komunitetit në modelet e zgjidhjes së problemeve.	DO, DH, DK	DShM, Institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare, forumet e	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i problemeve të zgjidhura sipas modeleve

				sigurisë, shoqëria civile, mediat	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i fushatave, takimeve, debateve
	1.3.4. Sensibilizimi dhe vetëdijesimi i qytetarëve me qëllim të parandalimit të dhunës në familje dhe delikuençës së të miturve.	DO, DH		DShM, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare, forumet e sigurisë, shoqëria civile, mediat	Në vazhdimësi	Kosto e buxhetuar /donacion	Numri i fushatave, takimeve, debateve
	1.3.5. Stimulimi i vullnetarizmit qytetar në funksion të fuqizimit të KLSP-ve.	DO		DShM, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare, forumet e sigurisë, shoqëria civile, mediat	Në vazhdimësi	Kosto e buxhetuar /donacion	Numri i veprimeve të realizuara
1.4. Ngritja e kapaciteteve operacionale dhe profilizimi i njësive	1.4.1. Krijimi dhe operacionalizimi i ekupeve për reagim dhe kontrollë anti-terror, kërkim-shpëtim dhe zhytje.	DO, DH, DK, DBNj, DShM		Institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	2017	Kosto e buxhetuar /donacion	Ekipet e krijuara dhe të operacionalizuara
	1.4.2. Profilizimi i zyrtarëve të njësive përkatëse për trajtimin e rasteve me materie radiologjiko-biologjiko-kimike.	DO, DH, DK, DBNj, DShM		Prokuroritë, Gjykatat, Institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	2019	Kosto e buxhetuar /donacion	Numri i zyrtarëve të profilizuar
	1.4.3. Operacionalizimi i	DO, DBNj,		Qeveria	2018	Grant	Njësia e

		Njesisë se Helikopterëve	DShM	Kosovës		qeveritar, 35.000.000 euro	operacionalizu ar
2. Parandali mi luftimi krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve të rënda si dhe terrorizmit	2.1. Fuqizimi i kapaciteteve në parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, të krimeve të rënda, të korrupsionit dhe terrorizmit.	2.1.1. Vlerësimi i krimeve nga krimi organizuar (SOCTA) dhe analiza vjetore strategjike.	DH	DO, DK, ILECU, prokuroritë, gjykatat, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto administrat ive	Pesë raporte vjetore
		2.1.2. Ngritja e efikasitetit në ngrirje, sekuestrim dhe konfiskim të aseteve të përfituara nga veprat penale.	DH, DO, DK	Prokuroritë, gjykatat, ATK, Doganat, AKK, NjIF, AAPSK dhe agjencitë tjera.	Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar	Asetet ngrira, sekuestruara, konfiskuara.
		2.1.3. Aplikimi i metodave të veçanta të hetimit.	DH, DO, DK	Prokuroritë, Gjykatat	Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar	Numri i rasteve në të cilat janë aplikuar metodat
	2.2. Bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional 1 dhe ndërkombëtar	2.2.1. Shkëmbimi i informatave në mes të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.	DH, DO, DK, ILECU	Institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare , Prokuroritë, Gjykatat	Në vazhdimësi	Kosto administrat ive	Numri i informatave të shkëmbyera
		2.2.2. Themelimi i ekipeve të përbashkëta, zhvillimi i operacioneve të përbashkëta të hetimit me akterët vendorë dhe/apo zhvillimi i hetimeve	DH, DO, DK	ILECU, prokuroritë, gjykatat, institucionet partnere	Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar	- Numri i ekipeve të themeluara - Numri i operacioneve

		paralele ndërkombëtare.		vendore dhe ndërkombëtare		Në vazhdimësi	Kosto administrative	të zhvilluara
		2.2.3. Angazhimi i mëtejshëm për anëtarësim në organizata ndërkombëtare në fushën e sigurisë.	DPSCL	MPB, MPI, MD, DH, DO, DK, DBNj, DShM, ILECU		Në vazhdimësi	Kosto administrative	- Numri i aplikacioneve - Numri i anëtarësimeve
		2.2.4. Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve të përbashkëta në mes të agjencive për zbatim të ligjit, në fushën e parandalimit dhe luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve të rënda si dhe terrorizmit.	DBNj, DO, DShM	Institucionet vendore dhe ndërkombëtare		Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar /donacion	- Numri i trajnimeve - Numri i zyrtarëve pjesëmarrës
		2.2.5. Fuqizimi i kapaciteteve në fushën e teknologjisë informative, infrastrukturës fizike dhe burimeve njerëzore.	DShM, DBNj	DH, DO, DK		Në vazhdimësi	15.000.000 euro/donacion	- Numri i objekteve të ndërtuara/renovuara - Numri i pajisjeve të siguruara
		2.2.6. Gjetja e modaliteteve të bashkëpunimit me INTERPOL, EUROPOL, SELEC, si dhe vazhdimi i bashkëpunimit me: FRONTX, SEEFEN, MARRI, DCAF, IOM, UNHCR, EXBS.	DH, DO, DK, DBNj, DShM, ILECU, DPSCL	MPB, MD, MPI, DShM, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare		Në vazhdimësi	Kosto administrative	Modalitetet e gjetura Vazhdimi i bashkëpunimit
2.3. Vetëdijësim	2.3.1. Organizimi i fushatave		ZIMP, DH,	Shoqëria civile,		Në	Kosto	Numri i

i i qytetarëve për pasojat e krimit të organizuar dhe korrupsionit, krimeve të rënda si dhe terrorizmit;	gjithëpërfshirëse përmes mediave elektronike dhe të shkruara.	DO, DK	mediat, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	vazhdimësi	buxhetuar	fushatave
	2.3.2. Organizimi i konferencave, seminareve dhe ligjëratave të ndryshme në shkolla dhe debate publike.	DH	DO, DK, DBNj, DShM, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare, shoqëria civile, mediat	Në vazhdimësi	Kosto e buxhetuar	Numri i konferencave/seminareve/li gjëratave/debateve
2.4. Identifikimi i hershem i popullsisë së targetuar për ekstremizëm dhe radikalizëm;	2.4.1. Identifikimi i individëve, grupeve, vendbanimeve, rajoneve të cilat janë të cënueshme ndaj influencimit me ideologji ekstremiste dhe radikale.	DH	DO, DK, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Caqet identifikuese
	2.4.2. Vlerësimi vjetor i gjendjes rreth ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në Republikën e Kosovës.	DH	DO, DK, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Pesë raportet vlerësuese të përpiluara
2.5. Identifikimi i hershem i faktorëve që ndikojnë në ekstremizëm dhe radikalizëm;	2.5.1. Përcjellja e rrjeteve sociale të hapura, për të identifikuar persona dhe elemente që në postimet e tyre shfaqin elemente dhe shenja të një sjellje radikale dhe ekstremiste.	DH/DO/DK	Institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Lista e personave të identifikuar dhe rrjeteve që përdoren
	2.5.2. Përpilimi i raporteve analitike lidhur me brengat	DH	DO, DK, institucionet	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i raporteve të

	ekonomike, politike dhe sociale që mund të ndikojnë në ekstremizëm dhe radikalizëm tek individë apo grupe të caktuara.		partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar	përpiluara
	2.5.3. Fushatë mediale me qëllim përcjelljen e mesazhit për pasojat e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit.	DH, ZIMP	DO, DK, bashkësitë fetare, shoqëria civile, mediat			Numri i fushatave realizuara
2.6. Rritja e vetëdijes së institucioneve për pasojat e ekstremizmit dhe radikalizmit dhe bashkëpunimi me komunitetin	2.6.1. Bashkëpunimi me forumet lokale të sigurisë (KKSB, KLSP, EVSB) nëpër komuna, komunitetin fetar, OJQ dhe shoqërinë civile përmes takimeve për identifikim të problemeve, brengave që ndikojnë tek personat për radikalizëm dhe ekstremizëm.	DO, DH, DK	MPB, MAPL, KK, shoqëria civile	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Takimet mbajtura
	2.6.2. Përpilimi i listës së OJQ-ve, të cilat me aktivitetin e tyre kategorizohen se kanë qasje/ bindje radikale/ekstremiste.	DH	DO, DK, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Listat përpiluara
	2.6.3. Përpilimi i listës me emrat e personave të cilët kanë ndikim në publik dhe që ndikojnë në përhapjen e ideve radikale/ekstremiste.	DH	DO, DK, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Listat përpiluara
	2.6.4. Organizmi i ligjëratave për zyrtarët e zbatimit të ligjit	DH, DO, DK	MPB, AKSP, DBNj, DShM	Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar	Ligjëratat mbajtura
2.7. Interveni	2.7.1. Identifikimi i	DH, DO, DK	Institucionet	Në	Kosto	Lista

	mi me qellim të parandalimit dhe zvogëlim të rrezikut nga ekstremizmi dhe radikalizmi i dhunshëm	personave që shfaqin shenja të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. 2.7.2. Shkëmbimi i informacioneve me Shërbimin Korrektues lidhur me profilin e personave të burgosur, në mënyrë që të intervenohet me programe për de-radikalizmin dhe re-integrim.	DH, DO, DK, ILECU	partnere vendore dhe ndërkombëtare Institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	vazhdimësi	administrative	personave të identifikuar
3. Kontrolli dhe mbikëqyrja e kufirit shtetëror	3.1. Avancimi i aktiviteteve në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit	3.1.1. Inicimi i harmonizimit të legjislacionit nacional me rregulloret përkatëse të BE-së, në fushën e menaxhimit të kufijve (Katalogu Shengen, rekomandimet dhe praktikat më të mira për kontrollin e kufirit).	DK, DPSÇL	MPB, MPI, MIE	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i informacioneve të shkëmbyera
		3.1.2. Pajisja e pikave të kalimit kufitar dhe stacioneve policore për mbikëqyrjen të kufirit me teknologji të avancuar për kontrollin e kufirit.	DK, DShM	ICITAP, EXBS, IOM, UNHCR dhe institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	600.000 euro/donacion	Numri i pikëkalimeve/stacioneve kufitare të pajisura
		3.1.3. Krijimi i njëjësive mobile dhe furnizimi i tyre me pajisje për parandalimin dhe luftimin e krimit ndërkufitar.	DK, DBNj, DShM	ICITAP, EXBS, IOM, UNHCR dhe institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	2017	400.000/donacion	Numri i njësive mobile
		3.1.4. Avancimi i sistemit	DK, DShM	ICITAP, EXBS,	Në	Kosto e	Numri i

3.2. Zbatimi i kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit në përputhje me standardet e Schengenit	mobilitet për mbikëqyrje të kufirit në vijën kufitare/vijën e gjelbër/vijën e kaltër, në pajtim me standardet e Shengenit.		IOM, UNHCR dhe institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	vazhdimësi	buxhetuar /donacion	pajisjeve mobile
	3.1.5. Avancimi i kontrollit kufitar, përmes fuqizimit të bashkëpunimit operacional me vendet fqinje për të parandaluar kalimin e paligjshëm të kufirit.	DK, ILECU	ICITAP, EXBS, IOM, UNHCR dhe vendet fqinje	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i aktiviteteve të përbashkëta
	3.1.6. Marrja e përgjegjësisë së mbikëqyrjes dhe kontrollit të kufirit me Republikën e Serbisë.	DK	MPB, KFOR	2018	Kosto e buxhetuar	Marrja e përgjegjësisë
	3.2.1. Përpilimi i planeve të përbashkëta me autoritetet e përfshira në MIK, në parandalimin dhe luftimin e krimit ndërkufitar.	DK/DH	Doganat e Kosovës, AUV	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i planeve të përbashkëta
	3.2.2. Patrullimet e përbashkëta me autoritetet e përfshira në MIK dhe me policitë kufitare të shteteve fqinje.	DK	Doganat e Kosovës, AUV dhe policitë e shteteve fqinje	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i patrullimeve të përbashkëta
	3.2.3. Përpilimi dhe shfrytëzimi i analizës së riskut në realizimin e planeve operative të përbashkëta.	DK	Doganat e Kosovës, AUV	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i analizave dhe planeve të përbashkëta
	3.2.4. Rritja e efikasitetit në	DK	DH, DO	Në	Kosto e	Aktivitetet e

	3.3. Krijimi i kushteve për qarkullim të lirë të njerëzve dhe mallrave në kufi	kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit në parandalimin dhe luftimin e krimeve ndërkufitare dhe migrimit të parregullt.		MPB, MPJ, shtetet fqinje dhe institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	buxhetuar	përbashkëta
		3.3.1. Inicimi dhe zbatimi i Marrëveshjeve dhe Protokolleve për Bashkëpunim dhe qarkullimit lokal ndërkufitar.	DK			Kosto administrative	- Kërkesat e iniciuara - Marrëveshjet e zbatuara
		3.3.2. Ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës dhe objekteve në pikëkalimet kufitare sipas standardeve ndërkombëtare	DK			200.000/donacion	Numri i objekteve të ndërtuara dhe modernizuara
	3.4. Kontrolli dhe mbikëqyrja e qarkullimit dhe qëndrimit të huajve me qëllim parandalimit të migrimit të parregullt	3.3.3. Ndërtimi dhe funksionalizimi i qendrave të përbashkëta me shtetet fqinje për shkëmbim të informacionit.	DK	DShM, shtetet fqinje dhe institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare		Donacion	Numri i qendrave të ndërtuara dhe funksionalizuara
		3.4.1. Zbatimi i masave operacionale për kontrollin, hyrjen, qëndrimin dhe lëvizjen e të huajve në territorin e Republikës së Kosovës.	DK	MPB, MPMS, Inspektorati i punës	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i operacioneve të përbashkëta
		3.4.2. Përmirësimi i profilit të analizës së rrezikut në procesin e identifikimit të kontrabandës dhe migrimit të	DK, DH	Doganat e Kosovës, AUV	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i analizave të riskut

4. Avancimi i menaxhimit të Burimeve Njerëzore	3.5. Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore të Policisë Kufitare	parregullt. 3.4.3. Avancimi i bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në fushën e parandalimit dhe luftimit të kontrabandës dhe migrimit të parregullt.	DK, ILECU DH,	Doganat e Kosovës institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i veprimeve të përbashkëta
4. Avancimi i menaxhimit të Burimeve Njerëzore	4.1. Zhvillimi i karrierës së punonjësve të Policisë Kosovës në përputhje me performancën në punë.	3.5.1. Trajnimet e përbashkëta të avancuara, ndërinstitucional dhe ndërkufitar, në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes së kufirit me qëllim të parandalimit dhe luftimit të krimit ndërkufitar.	DK, DBNj	EXBS, ICITAP, IOM, UNHCR, OSBE	Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar /donacion	Numri i trajnimeve realizuara
		4.1.1. Ngritja e cilësisë së kryerjes së vlerësimeve në PK.	DBNj	DH, DO, DK, DShM, DPSÇL	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Përpilimi i raporteve
		4.1.2. Rishikimi dhe plotësimi i udhëzimit administrativ dhe PSO-së për Gradime në Policinë e Kosovës.	DBNj, DPSÇL	DH, DO, DK, DShM,	2016	Kosto administrative	Udhëzimi dhe PSO të rishikuara
		4.1.3. Planifikimi dhe organizimi i proceseve të gradimit.	DBNj	DO, DH, DK, DShM	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i proceseve të organizuara
		4.1.4. Organizimi i takimeve dhe punëtorive lidhur me zhvillimin e karrierës dhe	DBNj	DO, DH, DK, DShM, DPSÇL	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i takimeve dhe punëtorive të mbajtura

vlerësimin e performancës.							
4.2. Avancimi i sistemit të menaxhimit të personelit në Policinë Kosovës.	4.2.1. Rishikimi i strukturës organizative dhe modifikimi sipas nevojës.	DBNj, DPSÇL	DO, DH, DK, DShM,	2016	Kosto administrative	Struktura e rishikuar	
	4.2.2. Implementimi i vazhdueshëm i rekomandimeve të IPK-së dhe të institucioneve tjera.	DBNj, DH, DShM, DPSÇL	IPK	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i rekomandimeve implementuara	
	4.2.3. Pjesëmarrja në konferenca, seminare dhe vizita studimore.	DBNj, DH, DShM, DPSÇL	Institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar /donacion	Numri i konferencave/seminareve/vizitave studimore	
	4.2.4. Funksionalizimi i plotë i sistemit PRIMIS.	DBNj, DShM	DO, DH, DK	2016	Kosto buxhetuar	Sistemi i funksionalizuar	
	4.2.5. Azhurnimi i listës së unifikimit të pozitave, në pajtim me listën e personelit të autorizuar.	DBNj	/	2016	Kosto administrative	Lista azhurnuar	
	4.2.6. Implementimi i klasifikimit të vendeve të punës për staf civil.	DBNj	DO, DH, DK, DShM	2017	Kosto administrative	Stafi i caktuar sipas pozitave të klasifikuara	
	4.2.7. Funksionalizimi i procesit për pensionimin, seleksionimin dhe rekrutimin e zyrtarëve policorë.	DBNj	MPMS, MF	Në vazhdimësi	41.000.000 euro	- Numri i zyrtarëve policorë të pensionuar - Numri i zyrtarëve të rekrutuar	
4.3. Kujdesi	4.3.1. Përkrahja dhe	DBNj	DO, DH, DK,	Në	3.000.000	Numri i	

shëndetësor për të gjithë të punësuarit përmes përkujdesjes shëndetësore efikase, brenda burimeve të disponueshme	mbështetja shëndetësore/psikologjike për punonjësit e Policisë së Kosovës.	DBNj	DShM, MSH, QKUK	vazhdimësi	euro	punonjësve përkrahur
4.4. Ngritja e cilësisë së programeve trajnuese	4.3.2. Organizimi i fushatave vetëdijësuese për parandalimin parësor të problemeve shëndetësore.	DBNj	MSH, DO, DH, DK, DShM, ZIMP	Në vazhdimësi	Kosto buxhetuar /donacion	Numri i fushatave
	4.3.3. Identifikimi i hershem i sëmundjeve përmes kontrollimeve mjekësore.	DBNj	MSH, DO, DH, DK, DShM,	Në vazhdimësi	Kosto e buxhetuar	Numri i kontrollave
	4.4.1. Identifikimi dhe analiza e nevojave për trajnim.	DBNj	DO, DH, DK, DShM, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto e buxhetuar /donacion	Nevojat e identifikuar
	4.4.2. Planifikimi dhe organizimi i trajnimeve në fushën e menaxhimit.	DBNj	DO, DH, DK, DShM, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	500.000 euro	Numri i trajnimeve të organizuara
	4.4.3. Organizimi i trajnimeve bazike dhe të specializuara, në fushën e hetimeve, sigurisë publike, kontrollit dhe mbikëqyrës së kufirit, teknologjisë informative dhe burimeve njerëzore.	DBNj, DH, DShM	Institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	2.000.000 euro/donacion	Numri i trajnimeve të organizuara

5. Standardi i zimit i infrastrukturës fizike, teknike dhe i teknologjisë informative	5.1. Përmirësimi dhe avancimi i kushteve të infrastrukturës dhe standardizimi i objekteve	4.4.4. Rifreskimi i programeve aktuale të trajnimit dhe krijimi i programeve të reja bazike dhe të specializuara.	DBNj	DO, DH, DK, DShM, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto administrative	- Numri i programeve të rifreskuara - Numri i programeve të reja
		4.4.5. Identifikimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të personelit trajnues (certifikimi i personelit të ri dhe trajnimi i vazhdueshëm i kapaciteteve ekzistuese).	DBNj, DH, DShM, DO, DK,	Institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto e buxhetuar	Numri i trajnerëve të certifikuar
		4.4.6. Hartimi dhe zhvillimi i standardeve për trajnerë dhe trajnime.	DBNj	DO, DH, DK, DShM, institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Standardet e krijuara për trajnerë dhe trajnime
		4.4.7. Inicimi dhe hartimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me qendrat e ndryshme ndërkombëtare dhe vendore që ofrojnë trajnime.	DBNj, DPSÇL	Institucionet partnere vendore dhe ndërkombëtare	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i kërkesave të iniciuara dhe marrëveshjeve
		5.1.1. Standardizimi i objekteve policore në përputhje me kategorizimin e tyre.	DShM	DO, DH, DK, DBNj	2020	5.000.000 euro	Numri i objekteve
		5.1.2. Modernizimi i infrastrukturës ekzistuese.	DShM	DO, DH, DK, DBNj	2020	2.000.000 euro	Numri i projekteve të realizuara

policore	5.1.3. Reduktimi i shpenzimeve të sistemit të ngrohjes.	DShM	DO, DH, DK, DBNj	2020	900.000 euro	Kostoja reduktuar
5.2. Rregullimi i statusit pronësor të objekteve policore	5.2.1. Procedimi i kërkesave në institucionet përkatëse kompetente për marrjen e parcelave për ndërtimin e objekteve të reja policore.	DShM, DPSÇL	KK	Në vazhdimësi	Kosto administrative	Numri i kërkesave të realizuara
5.3. Zgjerimi dhe avancimi i Sistemeve Informativ të Policisë Kosovës	5.3.1. Avancimi dhe zgjerimi i Sistemit Informativ të PK-së (SIPK).	DShM	DO, DH, DK	2017	150.000 euro	- Numri i moduleve të shtuara - Numri i përdoruesve
	5.3.2. Avancimi dhe zgjerimi i Sistemit për Menaxhimin e Kufijve (BMS).	DShM	DK	2016	250.000 euro	Sistemi i avancuar
5.4. Ngritja e nivelit të sigurisë kibernetike	5.4.1. Krijimi dhe funksionalizimi i njësisë CERT/CSIRT për reagim ndaj kërcënimeve kibernetike.	DShM	DBNj	2016	Kosto buxhetuar	Njësia funksionalizuar
	5.4.2. Krijimi i vazhdimësisë së punës dhe qendrës për rimëkëmbje nga fatkeqësia.	DShM	/	2018	1.000.000 euro	Qendra funksionalizuar
	5.4.3. Implementimi i sistemit të parandalimit nga kërcënimet kibernetike.	DShM	/	2017	300.000 euro	Sistemi implementuar
	5.4.4. Implementimi i sistemit të autentifikimit të dyfishtë.	DShM	/	2020	200.000 euro	Sistemi implementuar

5.5. Instalimi i sistemit digjital të sigurisë së sistemit të monitorimit të kamerave CCTV dhe ANPR.	5.5.1. Instalimi i sistemit të kamerave vëzhguese CCTV në të gjitha objektet e PK-së.	DShM	DO, DH, DK	2019	800.000 euro	Numri i kamerave të instaluara në raport objekte policore
	5.5.2. Instalimi i sistemit të kamerave ANPR statike dhe mobile, në të gjitha pikat kufitare dhe integrimi i tyre me sistemin BMS dhe SIPK.	DShM	DK	2017	300.000 euro	Numri i kamerave të instaluara në raport objekte policore
5.6. Avancimi i sistemit të komunikimit të PK-së.	5.6.1. Krijimi i sistemit digjital të komunikimit.	DShM	DO, DH, DK	2020	10.000.000/donacion	Sistemi digjital i funksionalizuar
	5.6.2. Avancimi i sistemit të telefonisë për linja emergjente në Qendrat e Komunikimit në PK.	DShM	ICITAP	2018	150.000 euro	Sistemi i avancuar i linjave emergjente



**PLANI ZHVILLIMOR STRATEGJIK
STRATEŠKI RAZVOJNI PLAN
STRATEGIC DEVELOPMENT PLAN**